



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 18/2010

Prishtinë më 05.05. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Murselj Haljilji, Zef Morina, Qamile Morina, Muferra Shiniq, Nerxhivane Dauti dhe Kaqusha Jashari.

Munguan: Fatmir Rexhepi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Tmava, Ibush Jonuzi, Azem Rexhaj dhe Zenun Elezaj – KPMM; Osman Ejupi dhe Ahmet Krasniqi - KKK, Haxhi Gashi – USAID, Dritan Selmanaj – KDI, Floriana Shala dhe Sanije Berisha - OSBE dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi Mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të 27. 04. 2010;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27. 04. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 27. 04. 2010 u miratua pa vërejtje.

Kryetarja e ftoi kryetarin e Bordit të KPMM – së, Ahmet Tmava, që të raportojë para Komisionit lidhur me Raportin vjetor të KPMM - së për vitin 2009.

Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009

Ahmet Tmava: Tha se kemi tentuar që Raporti të jetë me një përfshirje gjithëpërbërëse, të bëjë përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi duke dhënë edhe informacione të një viti paraprak, në mënyrë që të përdoret edhe si mjet krahasimi duke afruar edhe përshkrimin e gjithë realitetit për vitin e kaluar, në mënyrë që në këtë vit të hyjmë në realizimin e synimeve që janë në interes për ne edhe për ju. Ai tha se nuk do të lëshohem në detaje më shumë nga se besoj që në Raport me një gjithëpërfshirje kemi dhënë mundësinë që bashkë ta diskutojmë, të ju informojmë se kemi qenë edhe në Komisionin për Financa dhe vërejtjet e sugjerimet tuaja janë marrë dhe do të merren parasysh në mënyrë që bashkërisht të krijojmë një strategji për arritjen e synimeve dhe sukseseve sa më të mira. Me kënaqësi do t'i japim sqarimet që janë në interesin tuaj.

Ethem Çeku: Shprehu brengosje sepse Komisioni nuk e ka përfunduar procedimin e Ligjit të minierave, i cili do ta definojë shumë qartë punën e Komisionit të Pavarur të Minierave. Tha se nuk e di ku qëndron problemi, pse ligji është aq gjatë në procedurë të miratimit. Në vazhdim i theksoi disa nga dilemat dhe preokupimet, siç ishin listat e kompanive ilegale që veprojnë pa Ligj. Pyeti: cilat janë politikat e KPMM- së në këtë drejtim dhe mekanizmat e tjerë për të penguar çështjen që kanë të bëjnë me veprimet ilegale të këtyre kompanive. Ai kërkoi që një listë e tillë duhet t'i dërgohet edhe organeve përkatëse; e dyta ka të bëjë me licencën e Trepçës, si janë dhe deri ku janë duke u zhvilluar; çështja e tretë është me minierën e Sibovcit, si po shkojnë gjërat për çështjen e licencës edhe të Kosovës së Re? A e dini se çfarë licence keni për të lëshuar për minierën e Sibovcit? Këto janë tri çështje që i parashtroi. Po ashtu pyeti edhe për kompani që janë tërhequr nga Kosova gjatë kohës së hulumtimit. Pra, a keni rënje apo ngritje të kompanive që kanë aplikuar për marrjen e licencës dhe për hulumtim për minierat metalore? Sa i përket anës financiare ju keni biseduar me Komisionin, unë nuk dua të ndërhyj dhe shprehu mirënjohjen për materialin e dërguar me pasqyrën përfundoi Çeku.

Sala Berisha Shala - Tha se e kemi marrë Raportin dhe e kemi analizuar aq sa kemi pasur mundësi. Mendoj së është i hartuar në mënyrën më afirmative sa i përket punës së tij njëvjeçare, qëllimisht po them mënyrën afirmative, sepse për të nxjerrë diçka realisht nuk duhet t'i hedhim shumë kozmetikë afirmative, por të paraqitet situata ashtu siç është reale, në qoftë se dëshirojmë që minierat ta kenë kahjen e duhur, në mënyrë që t'i hapen dyert zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Unë jam munduar që ta bëj një krahasim me Raportin e vitit të kaluar, që e ka sjellë kjo agjenci dhe në Raport nuk shoh ndonjë ecje përpara me raportin e vitit të kaluar, me përjashtim që është plotësuar numri i Bordit të KPMM- së. Dihet se ky plotësim i Bordit nuk reflekton në Raportin e vitit paraprak kalendarik. Unë do t'i shkoj me rend Raportit dhe në faqen 11 kemi aktivitetin e KPMM - së, kemi një pasqyrë sa licenca janë lëshuar për lejen e punës për shfrytëzim, ku mendoj se janë të përfshira në mënyrë gjenerale, mandej në faqe 12 i kemi projektet kryesore që janë kryer gjatë kësaj kohe dhe janë për t'i përshëndetur dhe për t'i përgëzuar, sepse këto janë projekte shumë të rëndësishme. Sa i përket edhe gjeoshkencave edhe fushës së minierave në përgjithësi, unë do të ndalem këtu te projekti i ashtuquajtur Plani i guroreve të Kosovës. Këtu e kam një pyetje: se sa po zbatohet plani i guroreve të Kosovës? Përderisa edhe më tutje i kemi në material operimet ilegale, të cilat kryesisht kanë të bëjnë edhe më këtë fushë. Operimet ilegale, mirëpo edhe operimet e tjera të licencuara që nuk mund të mirret edhe shumë si spekulim. Mirëpo konsideroj se nuk është konform me planin e guroreve të Kosovës. Mandej kemi edhe sistemin e sigurimit të eksplozivëve, mendoj se është në kompetenca të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nuk do isha ndalur shumë në këtë çështje, por te matjet ajrore gjeofizike unë edhe këtu e kam një pyetje se cilat janë efektet e këtij projekti? A i ka shërbyer Qeverisë së Kosovës për të projektuar më tutje për zhvillimin ekonomik? Apo ka mbetur vetëm në sirtare të KPMM – së? Këto të dhëna gjeofizike e që kanë kushtuar bukur shtrenjtë dihet që për një kohë kemi menduar se është një lluks të bëhen matjet gjeofizike përballë hapave në të cilat ka kaluar Kosova. Laboratori gjeologjik, ku është për momentin dhe në shërbim të kujt është? Kush e ka në operim laboratorin? Më tutje te kapitulli i aktiviteteve të KPMM- së për vitin 2009 licencimi, është te licencat për hulumtime gjeologjike kërkim – zbulim. Këtu thirreni me të drejtë në Rregulloren e UNMIK- ut 2005/03, për momentin është në fuqi deri sa të hyjnë në fuqi Ligji për miniera e minerale, që e kemi në procedurën përfundimtare. Thuhet se licenca për hulumtime zhvillimore ndryshohet në afat prej dy vjetësh, me mundësi vazhdimi, por unë konsideroj se kjo mundësi vazhdimi nuk është e pafundshme. Edhe mundësia e vazhdimit duhet ta ketë një afat kohor dhe dua të shohim saktësisht se si rregullohet kjo çështje. Konsideroj se kjo shprehje me mundësi vazhdimi është një mundësi për manipulim për legalizim të ilegaleve dhe konsideroj se nuk është në dobi të zhvillimit ekonomik. Këtu thuhet më tutje edhe për licencat për hulumtimet minerale ndërtimore mund të shohim në sipërfaqe maksimale deri në 50 hektarë, ndërsa për të gjitha mineralet e tjera deri në 100 kilometra katrorë, është fjala për të gjitha lejet? Mandej më tutje i kemi të gjitha tabelat e hulumtimit gjatë vitit 2009 faqe 17 dhe faqe 18, ku më tepër më ka provokuar emri “metalike”, këtu e keni shkruar metale, që janë diku 18 licenca të hulumtimit për mineralet metale, pra këtë tabelë e kemi në mënyrë gjenerale. Unë do të doja që të kemi një pasqyrë në mënyrë të detajizuar e të pasqyruara në kohën kur kanë aplikuar, mënyrën e aplikimit, a është e regjistruar në Kosovë dhe kushtet, a janë paraparë më rregulloren në fuqi, dhe ajo që më intereson më së tepërmi, është nga se ju e

keni një hartë të zonave me interes të veçantë të dërguar nga Qeveria dhe jam e interesuar se në ato zona a keni ndonjë kërkesë? Ose ndonjë aplikacion për licencë të hulumtimit, ose të shfrytëzimit, si dhe a është licencuar ndonjë kompani në këto zona, qoftë para ose pasi t'ju ketë ardhur harta me zona të interesit. Edhe këtu vlen e njëjta gjë. Te zona e licencimit për hulumtim, kohëzgjatja e licencimeve, me sa e di unë, varësisht nga numri i mineraleve që aplikon, i interesuari ose kompania është edhe kohëzgjatja e licencës së hulumtimit. Për mineralet ndërtimore është një kohëzgjatje tjetër, për minerale metalike është diçka tjetër, gjithmonë duke ju referuar rregullores në fuqi, por konsideroj se kohëzgjatja, sidomos te mineralet me rëndësi, siç janë mineralet metalike në këtë rast nuk po flasim për energjetikë, sepse nuk e di se a keni kërkesë për hulumtim për mineralet energjetike dhe kjo është një nga pyetjet e radhës. Ndërsa te mineralet metalike pafundësisht ju zgjatet koha e hulumtimeve, sigurisht edhe ju i dini dhe kishim pasur dëshirë ta kemi një pasqyrë për t'i parë se sa janë respektuar kriteret, se kohëzgjatja maksimale te mineralet metalike është dy vjet me mundësi vazhdimi, jo pafundësisht brenda dy vjetëve. Në këtu nuk e kemi pasqyrën që ta dimë se a është respektuar ky kriter dhe a është licencuar me 50% të zvogëlimit të sipërfaqës siç është paraparë. Është e njëjta gjë edhe në faqen 23, ku thuhet dhe ku është edhe pyetja ime te vërtetimet gjeofizike ku përfshihen matjet me aeroplan, metodat me tension të lartë. Këtu në faqen 23 kemi “trajtimi ose ruajtja dhe përpunimi i mineraleve”, ku përfshihet përdorimi i parimeve dhe krejt në fund është veprimtarit. Veprimtarit e tjera, të cilat mund të caktohen nga Komisioni kisha dashur ta di a keni ndonjë shembull? Cilat janë ato veprimtari? Faqe 27 i kemi aktivitetet e Departamentit të inspektoratit për shkak se Departamenti i inspektoratit është mjaft i rëndësishëm. Unë do të lidhem në një pikë, ku thuhet përcjellja e eksploziveve gjatë importit dhe deponimit, përgaditja e lejeve për minim dhe certifikimi i minandezësve KPMM-ja bënë certifikimin e minandezësve d.m.th. është e autorizime, ka bazë ligjore që ta bëjë certifikimin. Unë mendoj se duhet të rregullohen me ligj këto gjëra. Faqe 28, jemi të siguria në punë, ku janë lëndimet e shkaktuara gjatë vitit 2009, lista e lëndimeve gjatë vitit 2009 –të, këtu varësisht nga madhësia e operimeve minerare e minierave në këtë rast e shoh se te Feronikeli keni më së shumti lëndime gjithsej 79 lëndime, e kam fjalën te KEK- u, sepse i kemi 101, mirëpo në raport me numrin e punëtorëve dhe me sipërfaqen dhe operimin del se Feronikeli është një numër shumë i madh dhe desha të pyes se çka keni marrë ju, si inspektorat, ose si KPMM në këtë rast. Në faqen 29 në vazhdim u përmendën shkaqet më të shpeshta të konstatuara lidhur me aksidentet e ndodhura, këtu janë të gjeneralizuara. Mendoj se është dashur më në detaje se në cilën minierë, cili ka qenë shkakëtar ose faktori që e ka shtyrë të bëhet aksidenti ose lëndimi. Desha të flasë edhe për lejet e minimeve të cilat janë edhe këto në mënyrë gjenerale, ku thuhet se lejet e leshuara për minierat sipërfaqësore janë 227, për minierat nëntokësore 57. Minierat sipërfaqësore janë: guroret, ndoshta është fjala vetëm për guroret ose nëntokësoret. Kemi faqe, 32 lista e separacioneve ilegale, është interesant se numrin më të madh të këtyre operimeve ilegale, përkatësisht separacioneve ilegale mund të ndahet me rajone. Vërehet se në Gjakovë ka më së shumti, me qenë se kam qenë një kohë pjesë e KPMM- së e di që Gjakova, Rahovevi dhe Prizreni kanë qenë tri komuna, të cilat e kanë treguar një lloj refuzimi ndaj institucionit, që tashti thirret KPMM dhe po më duket se në bazë të kësaj pasqyre e ka pasur të njëjtën gjë dhe në atë kohë ka qenë numri i operimeve ilegale në atë rajon dhe në bazë të kësaj shihet se nuk e kemi ndonjë përmirësim. Tash do të kisha dashur ta shtroja pyetjen se a janë në pyetje e njëjta qasje

të atyre komunave apo është mosfunksionimi dhe mosefikasiteti i inspektorëve të atij rajoni? Faqe 35, mua më ra në sy një emër te kompanitë ilegale të shfrytëzimit të gurëve gëlqerorë dhe të zhavorit gjatë vitit 2009. Ky emër, Sami Duraku, a është ndonjë punëtorë? Te aktivitetet e Departamentit të Gjeologjisë e përshkruani se vërtet KPMM – ja, në një farë mënyre në përmasa të caktuara ka pasur rolin e funksionimit gjeologjik te Kosovës. Unë mendoj se nga që e ka pasur këtë rol ndoshta edhe ka pasur pengesa për ta çuar tutje Ligjin e minierave edhe ka qenë tendenca për me qenë vetë themelues të shërbimit gjeologjik. Uroj që kjo çështje të rregullohet dhe uroj që ai staf, i cili është mjaft i përgatitur të jetë pjesë e stafit të shërbimit gjeologjik të Kosovës. Këtu i kemi tabelat vijuese, që paraqesin rezervat e shfrytëzuara nga kompanitë. Këtu për mua është e pa qartë TM1, TM2 ? Nuk e di se çka do të thotë një shkurtesë, të cilën nuk e pashë as te lista e shkurtesave? Te arkivi i gjeologjisë, pra te arkivi i KPMM - së edhe këtu e kam një pyetje ku e di që arkivi është mjaft i pasur, sepse i ka trashëguar të gjitha të dhënat gjeologjike të aspektit të gjeologjisë dhe xehtarisë nga enti i hulumtimeve gjeologjike dhe enti i xehtarisë së atëhershme, d.m.th ka trashëguar një arkiv të vjetër, por tani vazhdon ta plotësojë edhe me një arkiv të re, por kisha dashur me ditë se sa është në funksion ky arkiv për Qeverinë dhe për publikun. Sa i përket të dhënave të trashëguara nga hulumtimet e mëparshme gjeologjike, që kanë qenë në Kosovë, po edhe nga veprimet e xehtarisë të minierave në Kosovë? Sa jeni shërbyer ju edhe gjatë licencimit të kompanive të tjera edhe me arkivin e gjeologjisë, në mënyrë që të mos bini ndesh me ndonjë kërkesë, siç e kemi rastin kur menaxhmenti i Trepçës i ka dërguar ankesë Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, edhe juve (KPMM). Në këtë rast nuk e keni përdorur fare atë arkiv? Edhe kjo është njëra prej pyetjeve. Faqe 44, janë projektet e vitit 2009, mbështetja e KPMM- së për analizat gjeokimike nuk e kam shumë të qartë këtu. Këto analiza kryhen në fakultet xehtaro- metalurgjike apo e keni laboratorin në KPMM? Edhe analizat gjeokimike i kryni të kompanive që bëjnë kërkesë për hulumtim, përkatësisht shfrytëzim ose çfarëdo qoftë tjetër. Plani i menaxhimit të resurseve minerale, faqe 47, këtu përmendet se është plotësuar me harta të detajuara të përmasave të cilat nuk po i përmendi. Një përshkrim i zonave minerale dhe pasaportat për zonat e interesit do të doja ta dija se a keni ndonjë aplikacion apo licencë në ato zona? Faqe 55, “buxheti i shpenzuar, përkatësisht kapitulli i buxhetit” e di që ky raport është shqyrtuar edhe në Komisionin e Buxhetit dhe Financave, mirëpo për kureshtjen time nuk e di se çka është diskutua atje e çka jo, sepse ata do t’i paraqesin rekomandimet e veta në seancë plenare, kur do të jetë në rend të ditës ky raport. Unë këtu te buxheti i shpenzuar i mallrave të vitit 2009, te përshkrimi- tabela e përshkrimit, e shoh numrin 6, shërbimi i arsimit dhe i trajnimit është një shifër, ku besoj se do të arsyetohet mirë, po prapë për mua janë shifra gjenerale, këtu është në interes edhe të deputetve të dihet se ku kanë shkuar mjetet e taksapaguesve. Për arsimim kemi nevojë gjithsesi, por a është kryer ky trajnim dhe a janë ritrajnuar, se kanë ndodhur shumë trajnime në kuadër të Departamentit të UNMIK- ut dhe a është paguar arsimimi në sektorin publik apo privat dhe mendoj se është në interes të deputetëve të dihet saktësisht se cilët individ kanë përfitua prej kësaj dhe çfarë trajnime kanë mbaruar. Mandej shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse është një shifër ku edhe këtu jam e interesuar ta dije se nga i keni marrë këto shërbime intelektuale dhe këshilldhënëse. Faqe 61 faturat e lëshuara dhe të paguara në vitin 2009, për mua është pak e pakuptimet te mineralet energjetike p.sh., e faturuar është më pak, ndërsa e paguar më shumë, do të doja edhe një sqarim rreth kësaj. Te tantimat nuk e di se a ka

hyrë në fuqi një udhëzim administrativ, të cilin e kemi punuar një kohë të gjatë në disa mbledhje disa vjeçare dhe nuk e di a është aprovuar ai udhëzimi administrativ apo keni vazhduar me tantiema siç kanë qenë të dhëna paushall nga UNMIK - u në atë kohë? Edhe kjo është një pyetje që do doja ta di. Te koordinimi institucional, cilat janë raportet tuaja me institucionet e tjera relevante, siç është Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor? Mendoj se duhet të mirret gjithsesi një pëlqim. Më tepër dua të vazhdoj më tutje me procedimin e aplikimit për lejen e hulumtimeve dhe shfrytëzimeve, cilat janë raportet me Ministrin e Energjisë dhe minierave dhe institucioneve të tjera? Cili është bashkpunimi? Ne më herët e kemi pasur një ankesë se të gjithë institucionet po ju përzihen nga pak juve. Unë do të doja t'i merrja të gjitha këto përgjigje në mënyrë të shkruara, nuk do ta kisha aprovuar këtë raport, ky do të shkoj më tutje edhe në Kuvend dhe për mos me pas divergjenca atje dhe mendime të ndryshme do ishte më mirë ta kemi ne më parë këto përgjigje e më pas të kaloj në Kuvend që të vazhdoj më tutje në procedim, përfundoi Berisha.

Kaqusha Jashari - Tha se as unë nuk jam shumë larg nga tema e separacioneve, sepse i kam afër. Unë mendoj se ky raport është gjithëpërfshirës dhe për mua nuk nuk do duhej të jetë edhe aq i detajizuar për Kuvend. Mendoj se është Raport i mjaftueshëm edhe gjithëpërfshirës për Kuvend. Në fund i kemi edhe ato të dhënat për problemet që janë dhe të cilat duhet të zgjidhen edhe cili është synimi, prandaj mendoj se është i mirë. Ju keni mundur t'i shënoni edhe minierat që janë ilegale, kompanitë ilegale, mirëpo janë të shumta sa që edhe KPMM - ja nuk do kishte zgjidhje se si të vepronte. Është obligim po ashtu edhe i Komunës të ketë shënime nga se do ishte e pa mundur që të regjistrohet të gjitha nga KPMM- ja. Me qenë se ky është problem që shkakton pasoja në shoqërinë tonë, do të doja ta dija se ku është problemi, a është për shkak të menaxhimit të dobët apo për shkak të infrastrukturës ligjore për mosintervanim? Te afati kohor i licencave, a mundet inspektorati i juaj ta përcjellë plotësimin e kushteve të licencës, nëse është detyrë e Departamentit të inspektimit, sepse çdo licencë i ka edhe kushtet e veta të shfrytëzimit edhe të vitit të kaluar, kur kemi pasur raportin për 2008 edhe tashti nuk jam bindur, mirëpo licencat e hulumtimit ju i keni deri më tani 177, që i keni dhënë a licencat e shfrytëzimit janë 209, edhe këto të posaçme janë 200. Ku është interesimi të licencat e hulumtimit? Pse është interesimi për hulumtim aq i madh? Pse këtu duhet të jetë më i madh shpenzimi se sa shfrytëzimi? Domethënë nga ana financiare këtu duhet me qenë një lavërdi tjetër. Mendoj se këtu duhet bërë një kontroll më serioz, se nuk ka logjikë ose unë nuk kam njohuri. Mua më kanë rënë në sy firmat, të cilat nuk e kanë licencën legale sikurse është në Strezoc. Këtu ka qenë miniera e njohur edhe është kualiteti i kësaj miniere ai që kërkohet për shtresën e fundit të asfaltit për rrugë, e te ne përdoret guri gëlqeror i cili nuk është i lejuar, si është e mundur mos me pas licencë edhe është në listen e separacioneve ilegale? Për mua është çudi dhe ju si KPMM duhet të keni kujdes për nevojën e tregut, për çka jepet edhe ku është nevoja, përfundoi Jashari.

Zef Morina: Vlerësoi se në përgjithësi Raporti është shumë i mirë, shumë i detajuar, ka material i cili është i mjaftueshëm dhe i nevojshëm të shihet puna e KPMM- së. Ajo që thanë kolegët është shqetësuese, situata e kompanive ilegale, të cilat që nga fillimi janë të palicencuara dhe punojnë në të zezë. Ato jo vetëm i shkaktojnë dëme terrenit ku punojnë por i shkaktojnë edhe humbje ekonomisë, vendit dhe buxhetit të Kosovës. Janë në një

farë mënyre konkurrentë të kompanive, të cilat paguajnë taksa e në anën tjetër me qenë ne një situatë jo të mirë. Vërtet numri është shumë i madh dhe nuk e di si qëndron puna e inspektoratit në kuadër të KPMM- së? Ndoshta nuk keni numër të mjaftueshëm, por nuk e di si e keni organizuar, a e keni kët, në kuadër të nivelit qëndror apo i keni të gjitha komunat? Kjo ndoshta kishte me qenë shumë më mirë që në kuadër të kuvendeve komunale t'i krijoni vendet e caktuara, ku ata duhet të jenë në mënyrë permanente sikur inspektorët e ndërtimit. Unë mendoj se këtu duhet me qenë më rigoroz, po e shoh një sugjerim këtu në fund që e keni menduar se si duhet vepruar, mirëpo nuk po më duket shumë bindëse se ju mund ta ndaloni këtë dukuri. Çështja tjetër është edhe licenca për hulumtim edhe licencat për shfrytëzim, ka shumë raste ku shihen këtu edhe në tabela se ka firmë që ka licencën për hulumtim e nuk ka licencën për shfrytëzim, a mos është loja gjoja që ata e kanë marrë licencën për hulumtim për një kohë të shkurtër dhe në të njëjtën kohë e përdor edhe për shfrytëzimin e atij materiali. Kështu që kishte me qenë mirë për ta sqaruar këtu pak më hollësisht kriteret e dhënies së licencës për hulumtim dhe natyrisht edhe kriteret e dhënies së licencës për shfrytëzim. Unë mendoj se ju duhet me qenë pak më të zëshëm për ndalimin e këtyre dukurive, sepse sot e vetmja industri që po funksionon është ndërtimi përfshirë në përgjithësi ndërtimin e objekteve po ashtu edhe ndërtimin e rrugëve. Pikërisht këto 170 -180 kompani, të cilat nuk paguajnë taksa janë shaktarë të mëdhenj të humbjes së buxhetit të Kosovës. Këtu duhet me qenë shumë më rigoroz, kështu që unë ju përgëzoj dhe personalisht e mbështes këtë raport, përfundoi Morina.

Murselj Halilji - Unë personalisht jam mjaft i impresionuar nga ky raport, ndërsa pyetja ime ka të bëjë se Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve, a ka filluar t'i rregullojë problemet që i shkaktojnë kompanit të cilat nuk kanë licencë, nga se mendoj se është një problem shumë i madh për buxhetin e Kosovës. Ju e dini se gjithkund në botë shteti duhet të financohet dhe nese buxheti nuk përkrahet atëherë ne asgjë nuk bëjmë. Në përgjithësi të dhënat janë korrekte, e përkrah po ashtu edhe mendimin e z. Zef, i cili theksoi konfuzitetin lidhur me dhënien e licencës për hulumtim. Së pari, para se të jepet licenca për shfrytëzim dhe kur të jepet duhet që ato licenca t'u jepen kompanive që bëjnë shfrytëzimin korrekt të pasurive, sepse Kosova është një shtet mjaft i pasur. Pyetja ime ka të bëjë, se çka mund të bëjë Agjencia juaj lidhur me këto kompani të palicencuara? Ata çka kanë për detyrë të paguajnë, këtu nuk ka të shënuar asgjë. Po ashtu më intereson për harxhimet e udhëtimeve zyrtare. Pse nuk ka ardhur deri te pagimi i këtyre detyrimeve? ërfundoi Halili.

Sala Berisha –Shala - Unë dëgjova shumë nga kolegët. Ata thanë se ndoshta ky raport nuk ka nevojë të jetë mjaft i detajizuar. Përkundrazi mendoj se duhet me qenë mjaft i detajizuar nga se tërë kohen mendojmë se çka po ndodh me minierat dhe mineralet, thjesht se çka po ndodh me pasurit tona nëntoksore? Njëherë në vit e kalojmë shkel e shko. Prapë po i kthehem materialit, mund të them se tabelat janë dhënë në mënyrë të gjeneralizuar. Po kthehemi te licencat e vitit 2008, te licenca me numër 74, ndërsa në vitin 2009 janë licencuar 53 licenca, pra një kompani mund të posedojë një numër të licencave edhe ne duhet ta dimë se cilat kompani janë licencuar dhe sa licenca i kanë marrë deri më tash? A ka kompani që është licencuar në vitin 2005, e prapë është licencuar në vitin 2009? Kjo është mjaft me rëndësi se e dimë që Feronikli i ka 10

aplikacione në institucionin tuaj për leje hulumtimi edhe këto vetëm në rajonin e Prishtinës, konstatoi Berisha.

Zef Morina - Tha se na intereson pse kompania nuk është licencuar? Ajo prapë e vazhdon punën?

Kaqusha Jashari – Tha se në Kuvend nuk hyn askush në ato detaje, se nuk është edhe tema. Mirëpo, KPMM - ja duhet të jetë shumë transparente për të afruar çdo detaj. Këtu janë cekur se cilat janë problemet, synimet. Si institucion nuk është i vetmi në Kosovë, duhet edhe Ministria e Ambientit të jetë e angazhuar. Prandaj mendoj se nuk duhet t'i ketë të gjitha ato detaje, konstatoi Jashari.

Ethem Çeku: Tha se është shtruar një dilem që ky raport nuk i plotëson kriteret për të shkuar në Kuvend, do të thotë që sado që kryetari i Bordit të na informojë nga diskutimi rezulton se ky raport nuk i plotëson kriteret për ta dërguar në Kuvend. Prandaj mendoj që raporti duhet të plotësohet dhe të rishqyrtohet në njerën nga mbledhjet e ardhshme, propozoi Çeku.

Myzjene Selmani: Theksoi se është ndie një mungesë aktiviteti i KPMM- së, sepse Bordi i KPMM- së nuk ka qenë i kompletuar deri para pak kohësh. Pasqyrimi dhe aktivitetet e KPMM- së me këtë raport tha se janë bërë në mënyrën e duhur, por ka pasur mundësi që raporti të jetë ma i mirë. Kuvendi ju ka zgjedhur si Agjenci e pavarur dhe ju duhet të funksiononi të pavarur pa ndërhyrje nga jashtë. Duke marrë parasysh së bordi është shumë profesional, Raporti me duket shumë i pakapshëm, po ndoshta është shkak i mungesës së Ligjit për miniera dhe mineral, që akoma nuk është aprovuar. Në tabelën e anagramit, në faqen 10, paraqitet një listë e gurëthyesve ilegalë me një numër marramendës. Është absurd kur dihet së buxheti i Kosovës është mjaft i varfër, dhe se të gjithë jemi taksapagues të buxhetit. Atëherë as një gurthyes ilegal, nuk do duhej të lejohet nga se keni numër të mjaftueshëm të të punësuarave në KPMM. Me bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme duhet të ndalohen ta ushtrojnë veprimtarinë, në rast se nuk kanë licenca nga KPMM - ja nga se ju jeni formuar – zgjedhur që kompanitë të vinë të marrin licenca dhe në bazë të atyre licencave të mbushet buxheti i Kosovës. Është befasuese ky numër kaq i madh? Ne, si Komision, jemi për politika dhe sa herë që t'ju duhet ndihma jonë, në aspektin ligjor dhe politik, ne jemi të gatshëm të ju ndihmojmë. Po ashtu dhe Mistrria e Planifikimit Hapësinor është dashur ta ketë një plan strategjik dhe ai plan të ju shërbej edhe juve, si KPMM, në raste që ato kompani nuk marrin leje nga ju, atëherë ju e keni shumë ma lehtë për të vepruar. Ne, si Komision shumë shpejt do ta aprovojmë Ligjin për miniera dhe minerale dhe besoj në aspektin ligjor, në bazë të këtij ligji do të rregulloni shumë çështje dhe probleme me të cilat po ballafaqoheni si KPMM. Sa herë të shprehë interesim Komisioni parlamentar ne ju ftojme dhe ju jeni të obliguar të përgjigjeni nga se Kuvendi ju ka zgjedhur. Tani zoti Tmava, ju mund të përgjigjeni në pyetjet e parashtruara e për ato për të cilat tani nuk keni përgjigje na përgjigjeni me shkrim.

Ahmet Tmava: Tha se jam i vetëdijshëm se Raporti nuk është superlativ, ka edhe çështje të diskutueshme, të meta edhe gabime, por ideja e Raportit ka qenë të ju njoftojmë se ka

ndodhur një e keqe. Unë mund t'ju sjell raporte shumë të mira, mirëpo të keqën nuk mund ta bëj të mirë dhe shumë tema që këtu janë ngritur kanë qenë tema diskutimi edhe të Bordit. Tash po i flas edhe disa fjalë miradije për Bordin edhe për KPMM- në, sepse prej formimit të Bordit të ri, 100 kërkesa i kemi shqyrtuar dhe do të zbresim në zero. Kemi trashëguar një grumbull lëndësh që e kanë vështirësuar punën, sepse gjashtë muaj ka munguar Bordi dhe nuk kemi qenë si shumicë për të sjellë vendime. Do të jem shumë i drejtpërdrejtë. Ne i kemi prezantuar veprimet ilegale edhe unë tash po bashkëngjitem në vallen e juaj, sepse do të isha shumë me fat sikur veprimet ilegale që i kemi prezantuar të jenë vetëm këto, mirëpo ka edhe më shumë që po ua tregojë një koïdencë të rastit me emër dhe mbiemër Shpend Maxhuni, vendi në katin e dytë, zyra 41, sot ka pasur takim me ministrin, z. Rexhepi, ma ka dhënë adresën që të dalim dhe ta përgatitim strategjinë për ilegalitetin. Veprimi i ilegalitetit, nëse në vitin e kaluar i kemi dhënë 5 milionë për buxhetin e Kosovës, vetëm tash z. Ibushi e ka tërhequr për katër mujorin, kemi 2.600.600 euro. Unë nëse, do mundohem ta arrijë ilegalitetin, jo 5 milionë po mund t'i jepja edhe 10 milionë, edhe ky bord ka një dinamikë. E kemi ftuar edhe ministrin Sabri Ferati, për t'u harmonizuar. Kemi ftuar edhe kryetarë të komunave për të krijuar memorandum mirëkuptimi. Kemi pasur edhe takime me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, sepse të gjitha këto takime janë reflektuar mbas takimit që e kemi pasur me kryeparlamentarin. Kryeparlamentari na ka afruar të gjitha ndihmat që të ecim më tutje, në mënyrë që institucioni ta ketë atë reflektim që është autoritativ, përveç shtetit, sepse për momentin është veprimtaria e cila gjeneron më së shumti materiale, por edhe punësim. Tek e fundit edhe vetë dinamikat, të cilat janë në Kosovë e kanë vu në prioritet zhvillimin e resurseve, për fat edhe shumë resurse të tjera që kanë pasur kriza për shkak të çmimeve tash kanë prioritet. Të mos bëhet objekt i diskutimeve, që të gjitha të hudhen, nëse ka ndodhur një defekt, po them, nëse ka ndodhur me Çukën e Batllavës. Ne kemi marrë kërkesën e Trepçës dhe kemi thënë gjithçka do të bëhet transparente rreth procedurës së Trepçës. Ne kemi tentuar të jemi shumë korrekt dhe në Raport kemi prezantuar punën e vitit të kaluar. Unë nuk kam qenë pjesë e punës dhe mendoj se duhet të falënderohet dhe duhet të merren parasysh edhe vështirësitë që i ka pasur KPMM- ja për Trepçën. KPMM- ja do ta bëjë në detaje transparente Çukën e Batllavës. Për Sibovcin është shumë e vërtetë që KPMM- ja e ka të drejtën e përfaqësimit në Këshillin drejtues në "Kosova e Re". Zërin, e kemi ngritur dhe ju kemi informuar edhe juve, si Komision, se do të qëndrojmë fuqishëm edhe në çështjen e Sibovcit për Kosovën e Re, do të jetë në funksion vetëm për masën e licencës që e jep masa e licencës, nëse është 400 milionë kushtimisht do t'i marrë 400 milionë për licencë, por jo për krejt fushën e Sibovcit. Ne qëndrojmë fuqishëm, sepse e kemi edhe obligim. Neve na ka penguar edhe Ligji që po e presim. Ne e kemi luajtur rolin edhe në shërbimin gjeologjik, që është shumë e vërtetë se është potencuar. Mirëpo tash do t'i ruhem dhe kjo do të na japë komoditet që obligimet, si inspektorat ta bëjmë luftimin e ilegalitetit shumë më fuqishëm. Cilat janë kompanitë që janë tërhequr nga hulumtimet metalore? Kompanitë e hulumtimit, ta them të drejtën, këtë nuk e kam, se çdo kërkesë hulumtimi që na vjen te ne është një informacion me vlerë në aspektin si gjeolog, sepse më vjen një informacion prej terreni. Çdo hulumtim nuk do të thotë që reflekton me konkretizimin e akëcilit që bënë investime në zonat e interesit. Për fat të keq nuk është momenti i duhur të thuhet se kush është fajtor, por për fat të keq duhet të bëhet pasurimi dhe menaxhimi i resurseve që është edhe si projekt, i cili mendojmë që sa ma shumë ta avancojmë nivelin e studimit në mënyrë që t'i joshim

investitorët, zonat e interesit duhen të zgjerohen 01.29.39, përfundoi Tmava.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- 1. I rekomandohet KPMM - së që brenda afatit dyjavor të plotësojë Raportin vjetor të punës së KPMM- së për periudhën njëvjeçare 2009, dhe ta prezantojë para Komisionit.*
- 2. Plotësimi i Raportit të bëhet në pajtim me vërejtjet dhe pyetjet që janë të përfshira brenda procesverbalit të 05 maj 2010.*

4.Shqyrtimi i Raportit vjetor i Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009

Kryetarja Myzejeni propozoi që mbledhja të përfundojë me pikën e pestë dhe pika e katërt të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe ky propozim u miratua.

5. Të ndryshme

I) Mbledhja e radhës

Pas debatit, Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës të shqyrtohen

- 1. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009;*
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale;*

Mbledhja përfundoi në orën 13: 30

E përgatiti:

Njësia e Mbështetjes së Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani